



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government

---

**THIRRJE E HAPUR PËR NJË PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE NË TASK FORCËN E PËRBASHKËT PËR PROGRAMIN E PROGRAMEVE TË BNK-SË IPA III 2021-2027.**

Ministria e Pushtetit Lokal ne bashkëpunim me Platformën CiviKos hapin thirrjen për një përfaqësues nga shoqëria civile për Task Forcën e Përbashkët për programin e programeve të BNK-së IPA III 2021 – 2027.

Pas letrës së fundit drejtuar Qeverisë të Kosovës nga Komisioni Evropian, si dhe kërkesës për fillimin e programit të instrumentit të ardhshëm për ndihmë të para-anëtarësimin (2021-2027 IPA III), si dhe përfaqësues i strukturës operative përgjegjëse për menaxhimin e programeve të ardhshëm për bashkëpunim ndërkufitar: Kosovë - Maqedoni e Veriut, Mali i Zi – Kosovë, dhe Shqipëri – Kosovë, do MPL, si dhe në rastet e mëparshme, të programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA i kërkohet krijimi i task-forcave të përbashkëta. Këto task-forca janë organe kolektive të përbëra nga përfaqësues të ministrive të linjës, shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë nga të dy vendet që marrin pjesë në hartimin e programit. Prandaj, MPL në bashkëpunim me CiviKos do të përzgjedhin një përfaqësues nga shoqëria civile në task-forcat e përbashkëta të programeve.

**THIRRJA ËSHTË E HAPUR PËR TË GJITHA ORGANIZATAT, PAVARËSISHT NËSE JANË ANËTARE TË PLATFORMËS CIVIKOS OSE JO.**

**Roli i Task-Forcave**

Task-forcat e përbashkëta do të sigurojnë efektivitetin dhe cilësinë e planifikimit dhe programit strategjik për zbatimin e programeve për bashkëpunim ndërkufitar në të ardhmen 2021-2027, veçanërisht përmes:

- Identifikimit të nevojave nga fushat e lejueshme të programit;

- Lidhshmërisë së nevojave lokale me ato të identifikuar në nivel rajonal dhe kombëtar;
- Përgatitjes së strategjisë së programit, me theks të veçantë në të gjitha elementet e ndërhyrjes objektive;
- Vendosjes për alokimin e ardhshëm të fondeve që kanë të bëjnë me përparësi tematike;
- Përshkrimin të strategjisë së programit për çdo projekt strategjik, atëherë kur është e mundur.

Disa nga kriteret që OJQ-të nominuese dhe kandidatet duhet ti plotësojnë janë:

#### **PER OJQ-TE**

- Të jenë të regjistruar në Kosovë si OJQ;
- Të jenë aktiv së paku gjatë tre viteve të fundit;
- Të dëshmojnë angazhimin e tyre në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.

#### **KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KËTO KUSHTE**

- Përvojë së paku tri vite në organizatë (përvoja duhet të jetë në organizatën/rrjetin nominues ose në një organizatë/rrjet të ngjashëm)
- Përkushtim në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.
- Përvojë të dëshmuar në menaxhim të projekteve ndër-kufitare.
- Njohja e Gjuhës angleze.

#### **DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR NOMINIM**

Për të nominuar përfaqësuesit e tyre OJQ-të duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së;
- Nje letër motivuese (maksimum 1 faqe a4) te kandidatit/es se pse dëshironi te jeni pjese e kësaj task-force.
- Cv-në e kandidatit/es së nominuar nga organizata.

#### **AFATI PER NOMINIM**

Afati për nominim është nga data 02.07.2020 deri me date 07.07.2020 ora 17:00. Nominimin tuaj ( me te gjitha dokumentet e kërkuara) mund ta dërgoni përmes email ne [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net), ose përmes postes adresa: Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë. [Për shkak të situatës me Covid-19 nuk do te pranohen aplikacionet fizikisht ne zyre.](#) Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) ose numrit të telefonit 038 224 904.

## **NË RAST TË PROCESIT TË VOTIMIT**

Në rast se kemi më shumë se një kandidat/e që i plotësojnë kriteret atëherë CiviKos do të organizoj proces të votimit të hapur dhe transparent;

Pas finalizimit të kandidateve që i plotësojnë kriteret nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim, secila organizatë mund të votojë për 1 kandidatë për përfaqësues të OSHC-ve. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail në [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) , ose postë të rregullt ( Adresa: Rruga Bedri Pejani 7/A 1000 Prishtinë. [Për shkak të situates me Covid-19 votimi nuk do të jetë i mundur në zyre të CiviKos.](#)

Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos, dhe përfaqësues të MPL. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OSHC-ve në këtë task-forcë do të përcaktohet me short në mes tyre. Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve të gjitha OJQ-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe të interesuar të tjerë. Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nën-përfaqësuar.